

### Shtojca 3

#### Formulari i kërkesës për vazhdimin e lejes mjedisore

Emri i kompanisë	“RENELUAL TAHIRI” SH.P.K.
Lloji i veprimtarisë	Bazë për prodhimin e betonit
Vendi ku zhvillon veprimtarinë	Zona kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës i kompanisë	z. Refki Hoxha
Adresa	Rruga Joni 92/2, Prizren
Telefoni , fax, e-mail	049 113 194, 044 113 194 <a href="mailto:renelual_tahiri@hotmail.com">renelual_tahiri@hotmail.com</a>
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati
Adresa	Prishtina e Re, Prishtinë
Telefoni , fax, e-mail	<a href="mailto:edonak88@gmail.com">edonak88@gmail.com</a> +383 49 655 661
Numri i vendimit të lejes mjedisore paraprake	Vendimi për Leje Mjedisore;
Përshkrimi i dokumentacionit të bashkëngjitur kërkesës, përfshirë numri e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Çertifikata e Biznesit: 810610099</li> <li>Data e regjistrimit: 20.01.2004</li> <li>2. Vendimi për pëlqim mjedisor: nr.prot. 1078-2/22; datë 27.06.22</li> <li>3. Vendimi për Leje Ujore Shfrytëzim;</li> <li>4. Vendimi për Leje Ujore Shkarkim;</li> <li>5. Licenca e KPMM: 926/KPMM/2025; nr. prot. 3092 date 30.09.2025</li> <li>6. Fletat poseduese:</li> <li>7. Kopja e planit;</li> <li>8. Situacioni i terrenit;</li> <li>9. Informimi komunal;</li> </ol>
Fatura e pagesës se tarifës për vazhdimin e lejes mjedisore	Po
Një (1) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD).	Po

**Shtojca 1****Formulari i kërkesës për leje mjedisore**

<b>Emri i kompanisë</b>	<b>“RENELUAL TAHIRI” SH.P.K.</b>
<b>Lloji i veprimtarisë</b>	<b>Bazë për prodhimin e betonit</b>
<b>Vendi/lokacioni ku zhvillon veprimtarinë</b>	<b>Zona kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit</b>
<b>Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës si dhe vula e kompanisë</b>	<b>z. Refki Hoxha</b>
<b>Adresa</b>	<b>Rruga Joni 92/2, Prizren</b>
<b>Telefoni , fax, e-mail</b>	<b>049 113 194, 044 113 194 <a href="mailto:renelual_tahiri@hotmail.com">renelual_tahiri@hotmail.com</a></b>
<b>Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis</b>	<b>Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati</b>
<b>Adresa</b>	<b><a href="mailto:edonak88@gmail.com">edonak88@gmail.com</a> +373 49 655 661 Prishtina e Re, Prishtinë</b>
<b>Përshkrimi i dokumentacionit të bashkëngjitur kërkesës përfshirë numri e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit</b>	<b>1. Çertifikata e Biznesit: 810610099 Data e regjistrimit: 20.01.2004 2. Vendimi për pëlqim mjedisor: nr.prot. 1078-2/22; datë 27.06.22 3. Vendimi për Leje Ujore Shfrytëzim; 4. Vendimi për Leje Ujore Shkarkim; 5. Licenca e KPMM: 926/KPMM/2025; nr. prot. 3092 date 30.09.2025 6. Fletat poseduese: 7. Kopja e planit; 8. Situacioni i terrenit; 9. Informimi komunal;</b>
<b>Deklarimi i vlerës financiare të investimit të projektit (euro), nënshkruar nga personi përgjegjës i kompanisë</b>	<b>Po</b>
<b>Fatura e pagesës së tarifës për leje mjedisore</b>	<b>Po</b>
<b>Aplikacioni origjinal i plotësuar për leje mjedisore në pesë (1) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD).</b>	<b>Po</b>


## Shtojca 2

### Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNIEN E LEJËS MJEDISORE		
<b>1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME</b>		
<b>1.1. Të dhënat për operatorin</b>		
1.1.1.	Emri i subjektit	“RENELUAL TAHIRI” SH.P.K.
	Vendi	Zona Kadastrale Lubizhdë komuna Prizren.
	Adresa	Rruga Joni 92/2, Prizren
	Nr. i tel./fax	049 113 194, 044 113 194
	E-mail	<a href="mailto:renelual_tahiri@hotmail.com">renelual_tahiri@hotmail.com</a>
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	810610099 Data e regjistrimit: 20.01.2004
1.1.3.	Personi përgjegjës i kompanisë	z. Refki Hoxha
	Nr. i tel./fax	049 113 194, 044 113 194
	E-mail	<a href="mailto:renelual_tahiri@hotmail.com">renelual_tahiri@hotmail.com</a>
1.1.4.	Personi kontaktues përgjegjës për mjedis	Dr.sc. Edona Kabashi Kastrati
	Nr. i tel./fax	+383 49 655 661
	E-mail	<a href="mailto:edonak88@gmail.com">edonak88@gmail.com</a>
<b>1.2. Të dhënat për impiantin</b>		
1.2.1.	Emri i impiantit	“RENELUAL TAHIRI” SH.P.K. <b>Bazë për prodhimin e betonit</b>
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Kompania “Renelual Tahiri” shpk ndodhet nw zonwn kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit.


## 2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	<p>Sipas hartës së bashkangjitur, lokacioni ku është ndërtuar dhe ushtron veprimtarinë baza për prodhimin e betonit me objektet përcjellëse e kompanisë Renelual Tahiri Sh.p.k., gjendet në lokalitetin Lubizhdë, Komuna e Prizren. Lokacioni ndodhet në anën e djathtë të aksit të rrugës së transitit që lidh pjesën veriore të Prizrenit me fshatin Lubizhdë.</p> <p>Baza e betonit me objektet përcjellëse është e vendosur në ngastrën kadastrale nr. P-81813046-00984-3, me sipërfaqe prej 4,887 m<sup>2</sup>, si dhe në parcelën nr. P-71813046-00984-5, me sipërfaqe prej 5,584 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale Lubizhdë. Sipërfaqja e përgjithshme e të dy parcelave është 10,471 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “Lug kod Duba dhe Gole Njive”.</p> <p>Parcelat janë në pronësi private të pronarëve të kompanisë, z. Refki Hoxha, z. Nebi Hoxha, z. Lulzim Hoxha dhe z. Ali Hoxha, gjë e dëshmuar përmes fletës poseduese dhe kopjes së planit të lëshuara nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Prizrenit.</p> <p>Para ndërtimit të bazës së betonit, ngastrat kanë qenë kryesisht sipërfaqe të rrafshëta, të shfrytëzuara për kultivimin e kulturave bujqësore sezonale, ndërsa në periudha të caktuara kanë mbetur edhe si toka djerrinë.</p> <p>Lokacioni ku zhvillohet veprimtaria është i larguar rreth 300 m nga rruga rajonale Prizren–Suharekë, ndërsa mbi 150 m nga rruga e transitit. Terreni i parcelës është kryesisht i rrafshët dhe i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve industriale. Investitori ka realizuar ndërhyrjet e nevojshme për nivelimin dhe stabilizimin e sipërfaqes, duke e shndërruar atë në një platformë funksionale dhe të betonuar, në përputhje me kërkesat teknike dhe operative të veprimtarisë.</p> <p>Përzgjedhja e lokacionit është bërë duke marrë parasysh qasjen e favorshme në infrastrukturën rrugore, distancën e përshtatshme nga zonat e banuara, si dhe mundësinë për zhvillim efikas të procesit teknologjik të prodhimit të betonit, me ndikim sa më të kufizuar në mjedis.</p>
------	--	---



**Harta 1. Pozita gjeografike e Bazës së Betonit zk. Lubizhdë**

2.2.	Numri kadastral i parcelës	<b>Numri kadastral; P-81813046-00984-3, P-71813046- 00984-5</b>
2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e	Lokacioni ku zhvillohet aktiviteti i bazës për prodhimin e betonit karakterizohet si zonë industriale dhe afariste, me qasje të përshtatshme në infrastrukturën rrugore dhe me kushte të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve prodhuese. Zona përreth dominohet nga veprimtari ekonomike dhe objekte afariste, si stacione të


<p>tyre në atë zonë</p>	<p>karburanteve, servise të automjeteve dhe aktivitete të tjera të ngjashme industriale e komerciale.</p> <p>Në kuadër të kompleksit janë të vendosura objektet dhe pajisjet përcjellëse të nevojshme për funksionimin e procesit teknologjik, përfshirë rezervuarët e agregateve, rezervuarin e ujit, bunkerat, trafostacionin elektrik, gjeneratorin dhe infrastrukturën tjetër teknike. Impianti është projektuar dhe ndërtuar në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat bashkëkohore për bazat e prodhimit të betonit, ndërsa realizimi dhe mbikëqyrja e punimeve janë kryer nga profesionistë të fushës.</p> <p>Në të njëjtën zonë ndodhet edhe baza për prodhimin e asfaltit, në pronësi të kompanisë Renelual Tahiri Sh.p.k., çka e karakterizon më tej lokacionin si zonë me aktivitet industrial të konsoliduar.</p> <p>Objektet më të afërta të banimit ndodhen në një distancë prej mbi 360 m nga lokacioni i aktivitetit, ndërsa institucioni arsimor më i afërt, shkolla e mesme “Loyola”, gjendet rreth 2.2 km larg. Objektet e tjera të banimit dhe ato afariste ndodhen në distanca edhe më të mëdha.</p> <p>Bazuar në karakteristikat e lokacionit dhe distancën nga zonat e ndjeshme, vlerësohet se aktiviteti zhvillohet në një hapësirë të përshtatshme për veprimtari industriale. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme në mjedis, si dhe për përcaktimin e masave mbrojtëse dhe menaxhuese në kuadër të veprimtarisë së prodhimit të betonit.</p> 
-------------------------	--

2.4.	Të dhëna lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	<p><b>Bimësia dhe vegjetacioni</b></p> <p>Bazuar në shqyrtimet vizuale të zonës ku është i vendosur projekti, vegjetacioni karakterizohet kryesisht nga bimësi barishtore e ulët dhe kultura bujqësore, përfshirë misrin, grurin, tërshërën dhe tërfojën.</p> <p>Në zonën më të gjerë përreth lokacionit janë të pranishme edhe specie drusore dhe shkurre, si: qarri, bingu, gështenja, shelgu, plepi, akacia, murrizi, mana dhe manaferra.</p> <p>Sa i përket parcelës ku është e vendosur baza për prodhimin e betonit, më herët ajo ka qenë e shfrytëzuar për kultura bujqësore sezonale. Aktualisht, në këtë parcelë nuk ka vegjetacion të kultivuar, pasi sipërfaqja është e transformuar dhe e shfrytëzuar për qëllime industriale, përkatësisht për funksionimin e bazës së betonit dhe infrastrukturës përcjellëse. Në rrethin e afërt mbizotëron kryesisht bimësi barishtore e ulët.</p> <p><b>Bota shtazore (Fauna)</b></p> <p>Duke u bazuar në karakteristikat e vegjetacionit, kushtet klimatike të rajonit dhe të dhënat nga terreni, në këtë zonë hasen lloje të ndryshme të faunës, përfshirë gjitarë, zvarranikë, brejtës, insekte dhe shpendë.</p> <p>Ndër gjitarët dhe kafshët e egra që mund të hasen në zonën më të gjerë përfshihen lepuri i egër, dhelpra, ujku dhe derri i egër. Ndër brejtësit përfshihen minjtë, ndërsa nga zvarranikët janë të pranishëm gjarpri i zakonshëm, hardhucat dhe breshkat e tokës. Në aspektin e shpendëve, karakteristike janë bilbilat, thëllëzat e fushës, lejleku, sorra dhe shqiponja.</p> <p>Megjithatë, duhet theksuar se flora dhe fauna në këtë lokalitet është ndikuar ndjeshëm nga aktivitetet antropogjene, përfshirë zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe ndërtimin e objekteve industriale dhe afariste. Si rezultat, biodiversiteti në zonë është i kufizuar dhe relativisht i varfër.</p>
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	<p>Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë terren të afërt me lokacionin e bazës së betonit kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë/territor që është potencial të futet nën mbrojtje. Ndërsa në distancë më të largët ose nese flasim për komunën e Prizrenit si</p>

	zona të veçanta të mbrojtura kemi: Malet e Sharrit, Kalaja e Prizrenit, Ura e Gurit dhe objekte tjera të kultit religjioz.
--	--

### 3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

#### 3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet leja mjedisore



3.1.2. Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik

**Objektet e betonierës, pajisjet dhe fazat e procesit tekonologjik:**

Kompania “Renelual Tahiri” Sh.p.k., në Zonën Kadastrale Lubizhdë, Komuna e Prizren, ushtron veprimtari për prodhimin e llojeve të ndryshme të betonit përmes bazës së betonit të tipit “GURIS GCP-120”, prodhim nga Turqia. Impianti është projektuar për prodhim industrial të betonit dhe funksionon në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat operative për këtë lloj veprimtarie.

Baza për prodhimin e betonit përbëhet nga objektet, pajisjet dhe infrastruktura teknike në vijim:

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• objekti administrativ dhe objektet përcjellëse;</li> <li>• kabina kontrolluese dhe komanduese e impiantit;</li> <li>• impianti i betonierës të tipit “GURIS GCP-120”, me kapacitet prodhues deri në 135 m<sup>3</sup>/orë;</li> <li>• mikseri për prodhimin e betonit;</li> <li>• deponia dhe platoja për vendosjen e agregateve;</li> <li>• siloset për çimento, gjithsej 3 njësi me kapacitet prej 100 ton secila (kapacitet total 300 ton);</li> <li>• euro-filtrat e siloseve për kontrollin e pluhurit;</li> <li>• siloset për fraksionet e agregatit, me kapacitet të përgjithshëm prej rreth 100 m<sup>3</sup>;</li> <li>• sistemi për dozimin dhe matjen automatike të agregatit, çimentos, ujit dhe aditivëve;</li> <li>• shiritat transportues horizontalë dhe të pjerrët për furnizimin me agregat;</li> <li>• rezervuarët e ujit me kapacitet total prej 40,000 litra;</li> <li>• rezervuari për aditivë me kapacitet prej 1,000 litra dhe pompa për dozimin e tyre;</li> <li>• kompresori për furnizim me ajër të komprimuar;</li> <li>• pompat dhe sistemi i furnizimit me ujë;</li> <li>• gjeneratori për furnizim me energji elektrike me kapacitet 750 kW;</li> <li>• trafostacioni elektrik;</li> <li>• hapësira dhe sistemi për pastrimin e autocisternave;</li> <li>• rezervuari i naftës me kapacitet prej 5,000 litra;</li> <li>• konstruksionet metalike dhe platformat mbajtëse të mikserit dhe siloseve.</li> </ul> <p>Në impiant përdoren fraksione të ndryshme të agregatit, të ndara sipas granulometrisë, për përgatitjen e llojeve të ndryshme të betonit, në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet përkatëse të ndërtimit.</p> <p>Procesi teknologjik i prodhimit të betonit zhvillohet përmes fazave kryesore në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. furnizimi dhe deponimi i agregateve në hapësirat e dedikuara;</li> </ol>
--	--	--

2. transportimi i agregateve përmes shiritave transportues deri te sistemi i dozimit;
3. matja automatike e agregatit, çimentos, ujit dhe aditivëve sipas recepturave të përcaktuara;
4. përzierja e materialeve në mikser deri në arritjen e homogjenitetit të kërkuar;
5. shkarkimi i betonit të gatshëm në automjetet transportuese;
6. transportimi i betonit në vendin e përdorimit.

Në fotografitë në vijim paraqitet baza për prodhimin e betonit dhe pajisjet përcjellëse nga pozicione të ndryshme.





Fig. 2 Dozatorët e Rëres dhe Zhavorit



Fig. Gjeneratori I Rrymës elektrike





Fig. 4 Gropat për Trajtimin e ujit

### **Koncepti prodhues i betonierës**

Kompania “Renelual Tahiri” sh.p.k. në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, me veprimtari Bazë e betonit është përcaktuar të përdorë teknologji dhe pajime me të cilat mund të prodhoj të gjitha llojet e betonit të cilësisë së lartë. Materialet e nevojshme për prodhimin e betonit janë: çimentoja, fraksionet e gurit/rërës, uji dhe aditivët. Te cilat janë paraqitur ne foto e lartcekura.

Fraksionet e gurit/rërës janë: +0-4mm, +4-8mm, +8-16mm dhe +16-31.5 mm. Procesi i prodhimit të betonit është proces i mbyllur, i tërë procesi kontrollohet dhe menaxhohet në mënyrë të automatizuar.

### **Prodhimet e betonit**

Betoni paraqet konglomerat që përfitohet me përzierjen e çimentos, fraksioneve të rërës/gurit dhe ujit. Me programin e prodhimit parashihet prodhimi i këtyre llojeve të betoneve:

- Betonet Plastike 0-16 (MB15, MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Betonet Plastike 0-31.5 (MB10, MB15, MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Beton i Ajruar 0-16 (MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Beton i Ajruar 0-31.5 (MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Beton i Qëndrueshëm ndaj ujit 0-16 (MB20, MB25, MB30, MB35,)
- Beton i Qëndrueshëm ndaj ujit 0-31.5 (MB20, MB25, MB30, MB35)

Përpos këtyre llojeve të betoneve mund të prodhohen edhe lloje të veçanta të betoneve: për ndërtim të rrugëve, urave, tunele, për konstruksione nën ujë etj.

**Komponentët në procesin e prodhimit të betonit**

**Çimentoja-** paraqet komponentin lidhës të betonit. Sipas teknologjisë për prodhimin e betonit në bazën e betonit përdoret çimentoja portland. Në raste të veçanta varësisht prej llojit të prodhimit të betoneve, përdoren çimentot speciale. Cilësia e çimentos përcaktohet në bazë të aftësisë lidhëse të shprehur nëpërmjet fortësisë. Dallojmë disa lloje të fortësisë: 200, 320, 500, 600 dhe 800 kp/cm<sup>2</sup>. Çimentoja Portland nuk duhet të ketë aftësi në fortësi më të vogël se 320 kp/cm<sup>2</sup>. Sasia për prodhimin e betonit, përkatësisht harxhimi specifik i çimentos, është 200-400 kg për 1m<sup>3</sup>.

**Agregati - guri /ose rëra;** Kompania “Renelual Tahiri” sh.p.k. në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, me veprimtari Bazë për prodhimin e betonit me fraksionet e gurit gëlqeror furnizohet nga gurthyesit/kompanitë në regjion të komunës së Prizrenit. Agregati duhet të përmbush kushtet e parapara në pikëpamje të cilësisë dhe granulimit. Rëra cilësore duhet të jetë e pastër dhe me përbërje të lartë të kuarcit. Agregati duhet të jetë pa asnjë shtesë të cilat reagojnë me ujin dhe shkaktojnë shkapërderdhje, kloridet, sulfatet dhe komponimet tjera kimike që dëmtojnë vetit fizike dhe mekanike të betonit nuk guzojnë të jenë të pranishme. Materiet organike dhe humusi pengojnë ngurtësimin e çimentos në beton. Preferohet që raporti i agregatit në beton të jetë 1:2 - 1:7, varësisht prej llojit të betonit që kërkohet të prodhohet.

**Uji-** është komponent i rëndësishëm për lidhje gjatë prodhimit të betonit. Çështjen e ujit pronari e ka zgjidhur më anë të pusit, të cilin e ka shpuar dhe me anë të pompave e shfrytëzon sasin e nevojshme ose edhe e mbushë rezervuarin i cili nevojitet për mbajtjen e ujit rezervë për nevoja të betonierës, pusi dhe rezervuari gjinden në afërsi të betonierës dhe në pronësi të kompanisë “Renelual Tahiri” sh.p.k. në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, me veprimtari Bazë e betonit, të dyjat pusi dhe rezervuar janë të mbuluara dhe nuk kanë kontakt me ujërat atmosferike. Në procesin e prodhimit të betonit gjithnjë përdoret vetëm uji i pastër, uji që nuk përmban materie organike që formohen nga bimët e kalbura. Harxhimi



fraksionet	+0-4mm	+4-8mm	+8-16mm	+16-31,5 mm
përqindja	40%	15%	35%	25%
sasia	756kg	283kg	378kg	473kg = 1890kg
Çimentoja				320kg
Uji				220kg

Nga kjo recepturë e lartshënuar mund të caktohet edhe bilanci material për prodhimin e 1m<sup>3</sup> beton që shihet në tabelën e më poshtme.

Hyrja		Dalja	
Agregati	1890kg	1m <sup>3</sup> beton	2430kg
Çimentoja	320kg		
Uji	220kg		
Bilanci i përgjithshë	2430kg		2430kg

### ***Përshkrimi i procesit teknologjik të bazës së betonit***

Prodhimi i betonit në betonier fillon me përgatitjen e lëndëve të para: agregatit (fraksioneve të gurit apo fraksioneve të rërës), çimentos dhe ujit.

Procesi teknologjik për prodhimin e betonit, fillon me mbushjen e siloseve me rërë apo gurë me granulacione të ndryshme në varësi të markës së betonit që dëshirohet të prodhohet, siloset mbushen me anë të lopatës ngarkuese me fraksione të gurit ose rërës nga depoja e fraksioneve të agregatit, siloset janë të ndara njëra prej tjetrës me mure të pllakave të qelikut.

Proces tjetër paraqitet mbushja e siloseve me çimento të tipit të caktuar, mbushja bëhet me anë të auto-cisternave me proces pneumatik.

Në procesin teknologjik bëjnë pjesë tërë sistemi i pajimeve të furnizimit me ujë, pompave hidraulike, pneumatikës, pajimeve elektrike dhe automatike në veçanti.

a. Agregati nga të katër siloset ku në dalje të cilëve ndodhën dozuesit elektro - pneumatik të cilët me dhënien e komandës nga tabela komanduese hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike pasi ta lëshojnë sasinë e caktuar të agregatit në shiritin transportues që ndodhet nën siloset e agregatit i cili i transporton

		<p>granulacionet (fraksionet) e agregatit gjerë në enën e cila nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjerë në mikser (përzierëse) për prodhimin e betonit. Në dozuesit e fraksioneve më të imta janë të vendosur vibruesit me qëllim të rrjedhjes së fraksioneve sa më lehtë në enën e agregatit, kur të dozohet sasia e dëshiruar e agregatit, në transportier e pastaj nga transportieri shiritor në enën prej nga dërgohet në mikser (përzierës).</p> <p>b. Dozimi i çimentos në përzierës bëhet nëpërmes transportuesit kërmillor nga silosi. Çimentoja me ramje të lirë bien në transportuesin të vendosur nën silos, pastaj nëpërmjet transportuesit kërmillor dozohet në enën e peshojës për çimento. Zbrazja e enës së peshojës kryhet në mënyrë të programuar dhe atë në kohën e dozimit të agregatit në mikser (përzierëse). Ashtu që zbrazja e pajisjes për dozim të çimentos në mikser (përzierës) fillon automatikisht në momentin e fillimit të dozimit të agregatit nga ena në mikser (përzierës), apo disa sekonda më vonë. Gjatë kohës së zbrazjes së enës së peshojës me çimento duhet të lëshohet vibruesi, kur procesi kryhet në mënyrë manuele, kur procesi kryhet në mënyrë automatike vibruesi lëshohet në mënyrë automatike.</p> <p>c. Dozimi i ujit në përzierës si lëndë e parë bazë për përfitimin e betonit bëhet me dozimin e programuar nga pompa për furnizim me ujë kryhet gjithashtu në mënyrë automatike me fillimin e dozimit të çimentos. Pas dozimit të sasisë së caktuar të ujit, ventili dozues automatikisht mbyllet. Nëse janë përmbushë kushtet e procesit për punë automatike (sasia e nevojshme e agregatit në fortin, shtypja e ujit duhet të jetë min. 3 at. dhe sasia e nevojshme e çimentos), sasia e prodhuar e betonit për një cikël është <math>1\text{m}^3</math>, zgjatja e një cikli është përafërsisht 30 sek. në varëshmeri të llojit të betonit. Gjatë kryerjes së procesit në mënyrë manuele koha e zgjatjes së ciklit varët nga aftësia e punëtorit që operon me pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.</p> <p>Para se të lëshohen pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, duhet të kryhen këto veprime;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e agregatit në silose.</li> <li>- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e çimentos dhe duhet hapur vetëm ventilin e silosit nga i cili dëshirojmë të marrim çimento.</li> </ul>
--	--	--

- Duhet të sigurohet sasia e nevojshme e ujit.
- Duhet caktuar recepturën për kualitetin e betonit të cilin dëshirojmë të e prodhojmë.
- Të caktohet zgjatja e kohës së ciklit të prodhimit të betonit duke u bazuar në recepturën e caktuar.

Pajimet mund të funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar dhe në mënyrë manuale.

Menaxhimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit, kryhet nga pulti komandues i automatizuar i vendosur në dhomën (hapësirën) të caktuar për të.

Modulet hyrëse drejtpërdrejt pranojnë sinjalet nga dozatorët dhe peshojat, nëpërmjet sondave për të gjithë komponentët e procesit të prodhimit. Modulet digjitale dalëse shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetikë, motorëve si dhe llampave sinjalizuese.

Menaxhimi i terë procesit të prodhimit bëhet edhe përmes disa monitorëve të vendosur në panelin e komandimit, përmes këtij paneli operatorit i mundësohet të bëj mbikëqyrjen e terë procesit dhe recepturat për prodhimin e betonit, me këte mundësohet matja lehtë e komponentëve të agregatit, bitumenit dhe komponentëve tjera shtesë.

Për të arritur cilësinë e duhur të betonit bëhet sitja e çimentos me sita standarde dhe përcaktohet kohëlidhja e sajë, (kohëlidhja e çimentos paraqet kohën nga momenti i përzierjes së çimentos me ujë gjerë në momentin e fillimit të hidratimit të sajë dhe arritjes së fortësisë përkatëse). Përpos komponentëve të lartcekura për të arritur veçori specifike të betonit, duhet shtuar Aditivët. Në sezonin e dimrit dhe për konstruksione të veçanta shtohen aditivë të cilët e shpejtojnë kohën e ngurtësimit. Aditivi kryesisht shtohet me ujë, ose drejtë për drejt në mikser. Dozimi i aditivit kryesisht shtohet 2-4% të masës së çimentos.

Për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, me energji elektrike furnizohet nga rrjeti elektrik nëpërmjet trafos të ndërtuar nga kompania, gjithashtu ne mungesë të energjisë elektrike kompania posedon gjeneratorin për realizimin e procesit teknologjik të prodhimit të betonit.

		<p style="text-align: center;"><b>SKEMA E PROCESIT TEKNOLOGJIK TË BAZËS SË BETONIT</b></p>
3.1.3.	<p>Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve</p>	<p>Bazuar në kërkesat dhe praktiken e punës në këtë betonier, punët janë të organizuara vetëm në ndërrimin e parë.</p> <p>Hënë - Premte</p> <p>Orari i punës 08:00 – 17:00</p> <p>E shtunë</p> <p>Orari i punës 08:00-14:00</p>
3.1.4.	<p>Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor</p>	<p>Betoniera është e tipit GURIS GCP 120 kapaciteti i prodhimit 135 m³/orë.</p> <p>Duke marrë në konsiderat kohën e prodhimit dhe duke llogaritur që kompania punon në një ndërrim në 310 ditë në vitë, kapaciteti prodhues që mund të prodhoj kjo betoniere është:</p> <p>Kapaciteti për orë: 135 m³/h</p> <p>Kapaciteti për ditë: 1080 m³/ditë</p> <p>Kapaciteti për muaj; 27000 m³/ditë</p> <p>Kapaciteti për vitë; 297,7000 m³/vitë</p>
3.1.5.	<p>Të dhënat për shfrytëzimi</p>	<p>Komponentët hyrës në proceset prodhuese dhe aktivitetet operative të kompleksit të shfrytëzimit të betonit janë si më poshtë:</p>

	n e lëndës së parë dhe lëndëve ndihmëse.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fraksionet e agregatit mineral – rërë dhe zhavorr, që përdoren si material bazë për prodhimin e betonit.</li> <li>• Aditivët – shtesa të ndryshme për të përmirësuar vetitë fizike dhe kimike të betonit.</li> <li>• Çimentoja – komponent lidhës kryesor i betonit.</li> <li>• Uji – kompania furnizohet nga një pus i vetë-shpuar dhe, gjithashtu, është i lidhur me rrjetin e ujës-jellësit për nevojat e prodhimit.</li> <li>• Nafta – përdoret për shfrytëzimin e pajisjeve të motorizuara dhe makinerive ndihmëse.</li> <li>• Energjia elektrike – sigurohet përmes trafos personale të kompanisë, duke u furnizuar nga rrjeti elektrik publik i KEDS dhe e-Kos-Co.</li> </ul> <p>Ky grup komponentësh përbën bazën për realizimin e procesit të prodhimit të betonit, duke garantuar efikasitet dhe cilësi të qëndrueshme të produktit përfundimtar.</p>
3.1.6.	Lista e rezervuarëve dhe kapaciteti i tyre	<p>Kompania „Renelual Tahiri” Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit posedon rezervuarët;</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rezervuari i Ujit – 40,000 litra</li> <li>2. Rezervuar to Çimentos 3 x 100 t= 300 ton</li> <li>3. Rezervuar të Aditivit 3 x 1000 litra= 3000 litra - Rezervuari i aditive është i vëndosur në hapësirën brenda vaskës metalike, i njëjti transportohet me anë të pompës deri tek mikseri. Pra, adetivet nuk asnjë kontakt me pjesën e jashtme e as nuk preken nga ujërat atmosferike.</li> </ol>
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	<p><b>Lista e Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative për kompletimin e kërkesës për tu pajisur me leje mjedisore.</b></p> <p><b>Ligjet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025</li> <li>• Ligji për VNM Nr. 08/L-181</li> <li>• Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174</li> <li>• Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110</li> <li>• Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L-26</li> <li>• Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147</li> <li>• Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11</li> <li>• Ligji për Kimikate Nr. 08/L-116</li> <li>• Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025</li> <li>• Ligji për Mbeturina Nr. 08/L-071, për plotësim ndryshimin e ligjit nr. 04/L-060</li> <li>• Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102</li> <li>• Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012</li> </ul> <p><b>Udhëzimit Administrative:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit Administrativ (Mmph) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore</li> <li>• Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore</li> <li>• Udhëzimi administrativ Nr. 07/2017 për Lejen Mjedisore</li> <li>• Udhëzim administrativ (QRK) nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes</li> <li>• Udhëzimi administrative Nr. 05/2013 për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinat me vajra</li> <li>• Udhëzim administrativ mmph Nr. 04 /2018 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme.</li> <li>• Udhëzim administrative Nr.05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave.</li> <li>• Udhëzim administrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.</li> <li>• Udhëzimi administrative Nr.03/2021 për administrimin e mbeturinave të rrezikshme.</li> </ul>
--	--	---

<b>3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit</b>		
3.2.1.	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	<p>Kompania-betoniera “Renelual Tahiri”-Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonen kadastrale Lubizhdë, komuna e Prizrenit është e përkushtuar më të gjitha funksionet e saj organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm.</p> <p>Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësimin e vazhdueshëm I Mjedisit</li> <li>- Parandalimin e dëmtimit të Mjedisit</li> <li>- Respektimin e legjislacionit vendor</li> <li>- Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me autoritetet kompetente.</li> </ul>
3.2.2.	Raportimi	Nuk bënë Raportime

<b>1. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE</b>		
4.1.	Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse	<p>Gjatë funksionimit të kompanisë “Renelual Trahiri” Sh.p.k., e vendosur në zonën kadastrale Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, emisionet në ajër dhe ndotja lidhen kryesisht me aktivitetet e prodhimit dhe transportit të betonit. Burimet kryesore të ndotjes janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gazrat e djegies motorike nga automjetet transportuese të fraksioneve të gurit gëlqeror dhe të betonit. Gazrat përmbajnë komponime ndotëse me koncentracione të ndryshme, ku më të rëndësishmet janë: CO, NOx, HxCy, SO2 dhe Pb. Ndikimi i këtyre gazrave varet nga kushtet klimatike-meteorologjike dhe dendësia e qarkullimit të komunikacionit në lokacion.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pluhurat dhe grimcat e lira, të cilat shkaktohen nga: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Transporti dhe ngarkimi i betonit;</li> <li>○ Ngarkimi i çimentos në silos;</li> <li>○ Transporti i betonit me automikserë;</li> <li>○ Transporti i rërës dhe çimentos nga silosi te automikserët;</li> <li>○ Rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operationale pranë bazës së betonit.</li> </ul> </li> <li>• Burime të tjera të ndotjes: automjetet e transportit, automikserët, pompat, gjeneratorët dhe pajisjet ndihmëse.</li> </ul> <p>Duke u bazuar në përqendrimet e ndotësve të matura në lokacionin e kompleksit, rezulton se ndotja e ajrit mbetet brenda përqendrimeve të lejuara ligjore, dhe mund të kontrollohet lehtësisht me masat e duhura mbrojtëse dhe menaxheriale.</p>
4.2	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	<p>Gjatë realizimit të procesit teknologjik për prodhimin e betonit, ndotja e ajrit mund të ndodhë për shkak të disa burimeve kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Grimcat e pluhurit nga procesi i prodhimit të betonit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Nga përzierja e çimentos dhe fraksioneve të agregatit lirohen grimca pluhuri që, për shkak të peshës së tyre, gravitojnë drejt tokës dhe depozitohen kryesisht në afërsi të betonieres.</li> <li>○ Pluhurat përmbajnë elementë kimikë të çimentos dhe të materialit mineral të përdorur.</li> <li>○ Për shkak të kushteve mjedisore dhe relievit, disa grimca mund të transportohen edhe në distanca më të largëta.</li> <li>○ Kjo situatë mund të menaxhohet efektivisht përmes <b>masave të reduktimit të pluhurit</b>, si filtra, ujëra shprishëse dhe mbulime sipërfaqësore.</li> </ul> </li> <li>2. <b>Emetimi i pluhurit gjatë manipulimit të çimentos</b></li> </ol>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Lirimi i pluhurit gjatë zbrazjes së autocisternave dhe mbushjes së siloseve me çimento.</li> <li>○ Lirimi i pluhurit gjatë transferimit të çimentos nga siloset te mikseri, duke përfshirë vendet lidhëse të gypave transportues dhe sipërfaqet operacionale.</li> </ul> <p><b>3. Gazrat nga automjetet dhe pajisjet e transportit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Automjetet e transportit dhe pajisjet e tjera të rënda që përdoren gjatë procesit të prodhimit të betonit lëshojnë gazra motorikë, të cilët përmbajnë komponime ndotëse si CO, NOx, SO2, HxCy dhe Pb.</li> </ul> <p>Për shkak të masave mbrojtëse të aplikuara në bazën e betonit, ndikimi i këtyre ndotësve në cilësinë e ajrit <b>mbetet i kontrolluar dhe brenda kufijve të lejuar ligjorë.</b></p>
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	<p>Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse paraqiten nga pluhurat të cilët lirohen nga qarkullimi i automjeteve brënda dhe jashtë. Kompania <b>“Renelual Tahiri”</b> - Sh.p.k. Bazë për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pluhurat të cilët lirohen nga deponit të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të agregatit,</li> <li>- Pluhuri nga sipërfaqet manipuluese të kompleksit të baze së betonit.</li> <li>- Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të betonit.</li> <li>- Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të betonit nga silosi në automikserë.</li> </ul>
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	<p>Baza e betonit në fjalë posedon filtra të posaqëm për zvogëlimin e sasisë së pluhurit të shkarkuar në mjedisin e jashtëm.</p> <p>Për pluhurin i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të prodhimit të betonit përkujdesemi që të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, në mënyrë që të mos ketë ndikime të mëdha në mjedis.</p>

		<p>Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë procesit teknologjik të bazës së betonit përpos masave të lartë cekura kemi marr edhe masa tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bejmë mirëmbajtjen e rregullt e pajimeve për prodhimin e betonit e posaçërisht stabilimenteve të cilat janë burim i emisioneve të pluhurit.</li> <li>• Bëhet kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve të rënda dhe konsumuesve tjerë të lëndëve të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga mjetet e punës të jetë sa më kualitativ.</li> <li>• Bëhet spërkatja e sipërfaqeve manipuluese, rrugëve transportuese fraksioneve, sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta.</li> <li>• Të gjithë gypat që nevojiten për mbushjen e siloseve me qimento si dhe gypat të cilet e furnizojn mikserin me qimento kontrollohen rregullisht edhe pjesët lidhëse të tyre</li> <li>• Thaset e filtrave kontrollohen rregullisht dhe nëse demtohen ato ndërrohen.</li> <li>• Poashtu bëhen matje të pluhurave të depozitar dhe liruar gjatë aktivitetit të betonieres dhe raportojme në ministrin e mjedisit sipas kërkesave të tyre.</li> </ul>
4.5.	Pajisjet për de-pluhurin	<p>Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë funksionimit të kompleksit të bazës së betonit janë marrë këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjithmonë bëhet spërkatja e sipërfaqeve punuese, rrugëve transportuese deponis së rëres dhe zhavorit, sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta.</li> <li>• Kompania posedon ujë rezervë për spërkatje.</li> <li>• Kompania ka të montuar filtrate në silloset e çimentos për ndaljen e grimcave të pluhurit gjatë mbushjës/zbrazjës së silloseve.</li> <li>• Vazhdimisht bëhet kontrollimi i rregullt i thasëve filtrues dhe të dëmtuarit ndërrohen.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bëhet kontrollimi i rregullt teknik i makinave që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që emitimi i gazrave nga automjetet e punës të jetë sa më kualitativ.</li> </ul>
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Kompania “ <b>Renelual Tahiri</b> ”- Sh.p.k, bën Monitorim të emisioneve.
4.7.	Monitorimi i emisioneve/ cilësisë ë ajrit	Kompania – Betoniera “ <b>Renelual Tahiri</b> ”- Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Lubizhdë, komuna e Prizrenit, e cila si aktivitet ka prodhimin e betonit, në mënyrë periodike e bënë monitorimin e emisioneve.
4.8.	Raportimet	Nuk bënë raportime
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	<p>Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarrë këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Behët kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve transportuese që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet e lartë cekura të jetë sa më kualitativ.</li> <li>- Bëhet spërkatja me ujë e sipërfaqeve operacionale, larja e platos ku janë të vendosura pajimet për prodhimin e betonit, granulacionet e agregatit sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta të spërkatën me ujë.</li> <li>- Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të prodhimit të betonit mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin.</li> <li>- Për mënjanimin dhe zvogëlimin e sasisë së pluhurit kompania ka të instaluar sistemin e filtrave me thasë në siloset që përdoren për deponimin e çimentos.</li> <li>- Të gjithë gypat që nevojiten për mbushjen e siloseve me çimento, si dhe gypat të cilët e furnizojnë mikserin me çimento rregullisht kontrollohen, pjesët lidhëse të tyre të mbyllën hermetikisht me mbyllje adekuate.</li> <li>- Thasët e filtrave kontrollohen rregullisht dhe nëse dëmtohen ndërrohen.</li> </ul>

4.10.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	<p><b>Reduktimi i përqindjes së klinkerit në përzierje, duke përdorur materiale zëvendësuese si:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Hirin fluturues (fly ash),</li> <li>○ Zgurat industriale (slag),</li> <li>○ Mikrosilica.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorimi i përdoruesve të ujit (superplastifikues) për të ulur raportin ujë/cement dhe konsumin e klinkerit.</li> <li>• Përdorimi i çimentos me emetime të ulëta CO<sub>2</sub></li> <li>• Zëvendësimi i çimentos OPC (Ordinary Portland Cement) me: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Çimento CEM II / CEM III, me përmbajtje më të lartë të materialeve të përzierra pozolane dhe industriale.</li> </ul> </li> </ul> <p>Reduktimi i konsumit të energjisë në impiant</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Instalimi i: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Motorëve elektrikë me efikasitet të lartë (klasa IE3/IE4),</li> <li>○ Sistemeve të kontrollit VFD për transportuesit dhe mikserët.</li> </ul> </li> <li>• Përdorimi i ndriçimit LED në të gjitha ambientet e impiantit.</li> </ul> <p>Përdorimi i energjisë së rinovueshme</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Instalimi i paneleve fotovoltaike në çatitë e zyrave, depot dhe sipër strukturave të impiantit për të mbuluar pjesërisht konsumin e brendshëm.</li> <li>• Përdorimi i automjeteve Euro 5/6 dhe mirëmbajtja periodike për efikasitet maksimal.</li> <li>• Rikthimi i ujit të ricikluar në përzierje jo-strukturore ose si ujë teknik për larje.</li> <li>• Instalimi i filtër-silove me eficiencë të lartë për depozitat e çimentos.</li> </ul>
-------	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> <li>Spërkatja e sipërfaqeve me ujë për të reduktuar pluhurin dhe për të shmangur erozionin e tokës përreth impiantit.</li> </ul> <p>Zbatimi i ISO 14001 për mjedisin dhe ISO 50001 për menaxhimin e energjisë, duke u certifikuar për t'u përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme.</p>
--	--	--

<b>5. UJI</b>		
5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Kompania <b>“Renelual Tahiri”</b> - Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, e cila si aktivitet ka prodhimin e betonit, ujin për shfrytëzim e merr nga ujërat nëntokësor-pusi privat që gjendet në oborrin e kompanisë, i cili uji me pompa nxjerret nga pusi dhe shfrytëzohet për nevojat e aktivitetit të prodhimit të betonit dhe produkteve të tij, për larje të makineris dhe sperkatje të sipërfaqeve operationale.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësore apo në rrjetin e kanalizimit	Kompania <b>“Renelual Tahiri”</b> - Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, e cila si aktivitet ka prodhimin e betonit, ujërat nga shpërlarjen e pllato, automikserave dhe pompës i shkarkon në bazenin sedimentues të cilin e ka ndërtuar në oborrin e bazës së betonit ku ujërat kalojnë në tre bazene sedimentuese me këtë minimizohet mundësia e depërtimit të tyre në ujrë nëntokësore, pastaj uji i cili pastrohet mjaftueshem përdoret prap për qëllime të shpërlarjes dhe spërkatjes së sipërfaqës manipuluese. Ndërsa një pjesë e ujërave të kulluara kalojnë në gypin e kanalizimit i cili është në pjesën e epërme të bazenit, ku kalojnë ujërat dhe futen në sistemin e kanalizimit. Ujërat të cilët përdoren për qëllime sanitare, shkarkohen drejtperdrejt në recipient dhe me këtë minimizohet mundësia e depërtimit të tyre në ujërat nëntokësore.
5.3.	Ndikimet në ujë	Në kushte normale kjo betoniera nuk pritet të ketë ndikime në ujëra sipërfaqësore apo nëntokësore. Ndërsa ndikime negative në ujë shkaktohen nga: <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimet negative janë derdhja e ujërave të përdorura në procesin teknologjik për prodhimin e betonit, nga larja e automjeteve transportuese-automikserët, pompat, ujërta e lartës së pllato, etj., sepse kompania se ka të rregulluar shumë mirë impiantin për trajtim të ujërave.</li> </ul>

5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	<p>Në kompaninë <b>“Renelual Tahiri”</b>- Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, e cila si aktivitet ka prodhimin e betonit nuk gjenerojme ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, e rrjedhimisht as të ujërave nëntokësore, për faktin se nuk përdorën lënde të rrezikshme, e poashtu uji para se të shkarkohet në recipient kalon nëpër kanalën dhe pusin sedimentues e pastaj në gypin e kanalizimit andaj edhe nuk ka emisione të ujërave të ndotura.</p> <p>Kompania ndrrimin e vajrave të makinerisë, nuk e bënë në ambiente të hapura por vetëm në autoservis, andaj edhe nuk ka ndotje të ujërave nga këto vajëra, sepse të njëjtat grumbullohen dhe dorëzohen tek kompanit e licencuara për grumbullimin e tyre.</p>
5.5.	Trajtimi i ujërave të ndotura	<p>Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ujë janë marrë këto masa mbrojtëse si është ndërtimi i pusit sedimentues, dhe separatorët e vajërave dhe ujërave të zeza.</p> <p><i>Skemën teknologjike të trajtimit të ujërave të ndotura e paraqesim në vijim.</i></p> <div style="text-align: center;"> <p>Shema teknologjike e trajtimit të ujërave</p> </div> <p>Ujërat nga separatori dhe gropa septike nuk lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë derivate të naftës mbi 1mg/l dhe materie të suspenduara mbi 30mg/l në ujë.</p>

5.6.	Kontrolli dhe matjet	Kompania “ <b>Renelual Tahiri</b> ” Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, e cila si aktivitet ka prodhimin e betonit, bëjnë kontroll dhe matje të ujit të ndotur.
5.7.	Raportimi	Kompania “ <b>Renelual Tahiri</b> ” Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, e cila si aktivitet ka prodhimin e betonit, bëjnë raportime në aspektin e ujërave të shakruara.
5.8.	Leje ujorë për shfrytëzim të ujit	Kompania “ <b>Renelual Tahiri</b> ” Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, e cila si aktivitet ka prodhimin e betonit, posedon leje për shfrytëzim të ujit.
5.9.	Leje ujorë shkarkimin e ujërave	Kompania “ <b>Renelual Tahiri</b> ” - Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, e cila si aktivitet ka prodhimin e betonit, posedon leje ujore për shkarkim të ujit.
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Në lokalitetin e bazës së betonit është i ndërtuar dhe funksionon sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura të krijuara nga procesi i prodhimit të betonit, larjës dhe ujërave nga të reshurat atmosferike, ku janë bërë kolektorët për grumbullimin dhe sistemin gypor për bartjen e ujërave të ndotura nga tëra sipërfaqet operacionale të bazes së betonit dhe dërgohen për trajtim në seperatorin për pastrimin e ujërave të ndotur nga grimcat me të rënda, derivatet dhe vajrat të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operacionale, nga pajimet e punës, e pastaj ujërat e trajtuara në seperator lëshohen në recipient. Bazenet sedimentues, plotësojnë të gjitha kërkesat për kapacitete e shkarkimit, poashtu është paraparë edhe mundësia për matjen e sasisë dhe mostrim të ujërave të ndotura që shkarkohen në recipient.

<b>6. ZHURMA</b>		
6.1.	Burimet	Zhurma vije si rezultat i aktivitetet prodhuese të betonit kryesisht nga makinat gjatë procesit të prodhimit, ngarkimit dhe transportit të betonit betonit, pastaj gjeneratorët dhe mjehte tjera punuese në këtë betoniere, etj. Me shfrytëzimin e pajisjeve prodhuese në bazë të standardeve maksimumi i zhurmës në burim është 90 dB. Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës

		<p>nuk kalon 50 dB, kurse gjatë natës rrallë punohet, por edhe kur punohet nuk është më e madhe se 45 dB.</p> <p>Në vijim po e paraqesim në formë tabelore nivelin e zhurmës në varshmëri nga distanca.</p> <table border="1" data-bbox="630 415 1469 695"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Zhurma</th> <th colspan="4">Distanca (m)</th> </tr> <tr> <th>10</th> <th>50</th> <th>100</th> <th>500</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>90db –niveli Për pajisje moderne</td> <td>59</td> <td>45</td> <td>39</td> <td>25</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në bazë të vlerave të paraqitura në tabelë dhe duke pasur parasysh distancën e ndërtesave të banimit si dhe kapacitetin e pajimeve dhe numrin e mjeteve transportuese që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit. Duke pasur parasysh se punohet vetëm ditën, mund të konkludojm se baza e betonit nuk ka ndikime negative të mëdha në njerëzit që banojnë dhe veprojnë në rrethin të fabrikës/bazës së betonit.</p>	Zhurma	Distanca (m)				10	50	100	500	90db –niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25
Zhurma	Distanca (m)															
	10	50	100	500												
90db –niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25												
6.2.	Kontrolli dhe matjet	<p>Realizimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit i është ekspozuar zhurmës kryesisht nga pajiset dhe makinat gjatë procesit të prodhimit të betoni, si dhe gjatë procesit të ngarkimit dhe transportit. Janë bërë matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet janë bërë në afërsi të objekteve të banimit si dhe në oborr dhe brenda fabrikës. Analiza e zhurmës së matur tregon që ajo nuk tejkalon normat e parapara e ligj.</p> <p>Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas Ligjeve në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës të punësuarit në ato vende të punës përdorin mjetet kundër zhurmës.</p> <p>Kompania – Betoniera “<b>Renelual Tahiri</b>” - Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, e cila si aktivitet ka prodhimin e betonit, në mënyre periodike bënë matjen e nivelit të zhurmës.</p>														
6.3.	Raportimet	<p>Kompania – Betoniera “<b>Renelual Tahiri</b>” - Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit bënë Raportime mbi nivelin e zhurmës.</p>														

## 7. TOKA

7.1.	Ndikimet në tokë	<p>Në aktivitetin e prodhimit të betonit, ndikime negative në tokë paraqiten:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe ndërrimit të tyre, gjatë pëlcitjes të gypave hidraulik të mjeteve punuese, por qe eshte minimal.</li><li>- Ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe lëngëta që krijohen nga larja e auto-mikserëve, dhe automjetet tjera transportuese.</li><li>- Ndikim tjetër me rënësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura në pasusin e sipërm (ndikimet në ajër), si dhe ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese.</li><li>- Ndikim tjetër me rënësi në tokë paraqitet edhe nga deponimi i fraksioneve të agregateve si dhe depozitimi i pluhurit nga këto fraksione.</li></ul>
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	<p>Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë të cilat i kemi cek më lart janë ndërmarr këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vaji i makinave ndërrohet në vende të caktuara (autoservis) të betonuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë. Pastaj këto vajëra grumbullohen në bure të posaçme dhe merren nga kompanit e licencuara për grumbullimin e tyre.</li><li>- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në lokacionin e kompleksit grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara.</li><li>- Në mënyrë të rregullt të mirëmbahen stabilimentet që nevojiten për realizimin e procesit të riciklimit.</li><li>- Të gjitha sipërfaqet ku janë të vendosur gjeneratori, deponimi i vajrave dhe lubrifikanteve janë shtruara me beton dhe të mbuluara me pullaz.</li><li>- Mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo</li></ul>

		<p>nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin regjionale.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Është bërë plani për masat rehabilituese në rast ndonjë dëmtimi të mjedisit gjatë realizimit të procesit teknologjik.</li> </ul>
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	<p>Masat rehabilituese pas përfundimit të aktivitetit prodhues të betonit do të jenë:</p> <p><b>Objektivat e rikultivimit</b></p> <p>Pas përfundimit të aktivitetit prodhues, pajimet e betonierës do të çmontohen dhe në bazë të leverdis do të shitën si material i vjetruar. Bazamentet si dhe platot nga betoni do të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi të qytetit.</p> <p>Nga proceset teknologjike të prodhimit të betonit do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th. substrate të pa përshtatshme (sterile) për rikultivim. Substrate me përmbamës të gurit gëlqeror, rërës, zhavorri dhe betoni, etj. që pa tjetër duhet të largohen dhe bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte. ashtu qe të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim.</p> <p>Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:</p> <p>Qëllimi i rekultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punëve në procesin teknologjik, sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.</p> <p>Planifikimi i shfrytëzimit të tokës, planifikohet që toka në lokacionin e betonierës të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues, dhe të mbjellën të lashtat periodike të cilat kultivohen ne rrethin të lokalitetit.</p> <p><b><i>Struktura përfundimtare e sipërfaqeve</i></b></p>

Pas përfundimit të punimeve në betoniere me rikultivimin teknik do të krijohet një profil i ri i tokës, e cila mund të përdoret edhe për nevoja tjera. Propozohet që rikultivimi në ngastrat ku është vendosur baza e betonit, pos të lashtave bujqësore periodike të bahet me mbjelljen e fidaneve të ndryshme (pemëve) frytë dhënëse, pasi që sipërfaqja është e rrethuar me toka punuese mund të bëhet rikultivimi me mbjelljen e kulturave bujqësore periodike.

#### ***Rikultivimi teknik***

Në bazë të ligjeve të mjedisit çdo tokë e dëmtuar si shkas i aktiviteteve prodhuese, pas skadimit të afatit të shfrytëzimit ekonomik të projektit, investitori është i obliguar që tokës ti kthej pamjen e më pashme. Në bazë të punimeve të kryera hartografike- pedologjike në sipërfaqet e degraduara, duhet studiuar llojet e dëmtimeve si dhe intensitetin dhe ndikimin e tyre në botën bimore e pastaj të shqyrtohen mundësitë e sanimit të efekteve të pavolitshme si dhe rikultivimi i kësaj pjese. Gjatë rikultivimit teknik duhet të përvetësohet teknologjia e tillë që rikultivimi të kryhet.

Me krijimin e sipërfaqes së lirë nga largimi i pajimeve dhe bazamenteve të betonit të bazës së betonit duhet të fillohet me dizajnimin teknik të hapësirës së lirë duke bërë përgatitjen e terrenit për rikultivim teknik të sipërfaqes tokësore të degraduar. Degradimi i tokës gjatë realizimit të projektit shkon deri në at masë sa bëhet zhdukja fizike e profilit pedologjik të tokës, prandaj për këtë fazë të rikultivimit propozojmë krijimin e profilit pedologjik të tokës në sipërfaqet e dëmtuara. Për formimin e shtresës së sipërme sipërfaqësore produktive të tokës parashihet shtresimi i një shtrese të dheut prej 30cm gjerë në 50cm.

#### ***Rikultivimi agroteknik***

Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetitë agrokimike dhe pedologjike. Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re.

Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga veprimtaria e procesit teknologjik për prodhimin e betonit. Për të llogaritur numrin e fidaneve për tërë sipërfaqen që do të rikultivohet, duhet të kalkulohet me distancën në mes rendeve dhe distancën në rend.

$$N_f = S / a \times b$$

S - paraqet sipërfaqen, a – paraqet distancën në mes rendeve b – paraqet distancën në mes fidaneve. Në rastin tonë propozojmë që të dy këto distanca të jenë nga 2m. Në pjesët ku do të behët mbjellja e fidaneve duhet të vendoset një shtresë e humusit prej 0.3- 0.5 m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e këtij substrati me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte. Pas këtij operacioni duhet të bëhen vrimat në mënyrë të mekanizuar.

Thellësia e gropës duhet të jetë aq sa është i gjatë habitusi qendror i sistemit rrënjor të bimës, ndërsa gjerësia duhet të jetë e atillë që rrënjës t'i siguroj shtrirje sa më të lirë. Nëpër këto grupa duhet të hedhet 150 gr pleh mineral dhe pleh të djegur të shtallës e pastaj rreth bimës hidhet shtresa e dheut e cila duhet të jetë e ngjeshur sa më mirë. Të gjitha këto bimë duhet të kontrollohen me kujdes gjendja shëndetësore e fidaneve. Fidanet duhet të shoqërohen me ambullazh përkatëse ne momentin e blerjes. Nga sistemi rrënjor hiqen të gjitha pjesët e dëmtuara. Para se të mbillen fidanet, rrënjët e tyre duhet të zhyten në solucion prej bajage të freskët dhe argjili me qëllim që kjo përzierje të shërbejë si ushqim fillestar për bimën, si dhe dheu të ngjitet sa më mirë për rrënje. Bima e përgatitur në këtë mënyrë është e gatshme për mbjellje. Koha më e përshtatshme për mbjelljen e kulturave shumëvjeçare është vjeshta. Gjatë dimrit rrënja është aktive si dhe posedon sasi të optimale të lagështisë, kështu ne pranverë bima ka një startim më të suksesshëm. Mirëmbajtjes së plantacionit të krijuar duhet kushtuar kujdes i veçantë sidomos në ujitje, prashitje, krasitje etj. Pas mbjelljes së silvokulturave, investitori më tutje do të kujdeset për zhvillimin e tyre.

### ***Rikultivimi biologjik***

	<p>Qëllimi afatgjatë i rikultivimit biologjik është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siç janë: toka, flora, fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtarin bujqësore, blegtorale dhe në silvikulturë.</p> <p>Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikultivimit. Bimët të cilën e kemi propozuar në këtë projekt në sipërfaqet degraduara nga operimi i bazës së betonit janë mbjellja e fidanëve fryt dhënëse, duke e kombinuar me mbjelljen e kulturave bujqësore periodike.</p>
--	--

## 8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

8.1.	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	<p>Komponentët e mbeturinave të gjeneruara nga aktiviteti i kompanisë “<b>Renelual Tahiri</b>” Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonen kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, i përkasin kryesisht prodhimit të betonit dhe përpunimit të materialeve minerale. Trajtimi i tyre kryhet sipas rregullave ligjore dhe klasifikimit të Katalogut Shtetëror të Mbeturinave.</p> <p>Menaxhimi i mbeturinave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbeturinat komunale (jo të rrezikshme) deponohen në kontejnerë dhe më pas transportohen nga kompanitë e licencuara në deponitë rajonale.</li> <li>Vajrat motorike dhe lubrifikantët e përdorur nga pajisjet e kompanisë trajtohen si mbeturina të rrezikshme dhe dorëzohen tek ndërmarrjet e licencuara për grumbullimin dhe riciklimin e tyre.</li> </ul> <p><b>Klasifikimi i mbeturinave</b></p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 15%;">KODI I MBETURINËS</th> <th style="width: 35%;">EMRI I MBETURINËS</th> <th style="width: 20%;">SHKALLA E RREZIKSHMËRISË</th> <th style="width: 30%;">LLOJI I DEPONIMIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>01 04 08</td> <td>Mbeturina nga përpunimet fiziko-kimike të mineraleve jometalike</td> <td>Jo të rrezikshme</td> <td>–</td> </tr> </tbody> </table>	KODI I MBETURINËS	EMRI I MBETURINËS	SHKALLA E RREZIKSHMËRISË	LLOJI I DEPONIMIT	01 04 08	Mbeturina nga përpunimet fiziko-kimike të mineraleve jometalike	Jo të rrezikshme	–
KODI I MBETURINËS	EMRI I MBETURINËS	SHKALLA E RREZIKSHMËRISË	LLOJI I DEPONIMIT							
01 04 08	Mbeturina nga përpunimet fiziko-kimike të mineraleve jometalike	Jo të rrezikshme	–							

			01 04 09	Mbeturina nga përpunimet fiziko-kimike të mineraleve jometalike	Jo të rrezikshme	–
			01 04 10	Mbeturina nga përpunimet fiziko-kimike të mineraleve jometalike	Jo të rrezikshme	–
			01 04 12	Mbeturina nga përpunimet fiziko-kimike të mineraleve jometalike	Jo të rrezikshme	–
			13 01 11*	Vajra dhe lubrifikantë të përdorura	Të rrezikshme	Bure kompanitë e licencuara
			20 03 01	Mbeturinat komunale të përziera	Jo të rrezikshme	Kontejner / deponi qyteti
8.2.	Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave	<p>Gjatë aktivitetit të <b>“Renelual Tahiri”</b> Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonen kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, i gjenerohen mbeturina nga aktiviteti i prodhimit të betonit. Mbeturinat trajtohen fillimisht me magazinim të përkohshëm në mënyrë të kontrolluar dhe të sigurt.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbeturinat e ngurta komunale, vajrat dhe pjesët e vjetra të makinerive grumbullohen, klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm, të pajisur me kapak për mbulim dhe parandalim të ndotjes së ambientit.</li> <li>Pas magazinimit të përkohshëm, mbeturinat transportohen në deponitë rajonale ose dorëzohen tek kompanitë e licencuara për grumbullimin dhe trajtimin e tyre, sipas kategorisë dhe rrezikshmërisë.</li> </ul> <p>Ky proces siguron menaxhim të sigurt dhe të kontrolluar të mbeturinave, duke respektuar standardet mjedisore dhe ligjore për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.</p>				
8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe	Gjatë aktivitetit të <b>“Renelual Tahiri”</b> Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonen kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, nuk i nënshtrohen proceset e përpunimit apo riciklimit të mbeturinave.				

	riciklimi të mbeturinave	Të gjitha mbeturinat e gjeneruara nga aktiviteti i prodhimit të betonit magazinohen dhe transportohen direkt tek deponitë rajonale ose kompanitë e licencuara për trajtimin e tyre, sipas kategorisë dhe shkallës së rrezikshmërisë.
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër-kontratë me kompaninë me leje përkatëse	Kompania – betoniera “ <b>Renelual Tahiri</b> ”- Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonen kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, i gjenerohen mbeturina nga aktiviteti i prodhimit të betonit, përfshirë edhe mbeturinat e autoservisit dhe të pajisjeve të tjera. Të gjitha këto mbeturina transportohen dhe dorëzohen tek kompanitë e licencuara, të cilat kanë leje të vlefshme për grumbullim, trajtim dhe riciklim të mbeturinave, sipas kontratave të rregullta me kompaninë.
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Plani i menaxhimit me mbeturina do të mundëson: - Reduktimin e prodhimit të mbeturinave nga aktiviteti i kompanisë “ <b>Renelual Tahiri</b> ”- Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonen kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, synon të sigurojë kontroll të plotë mbi prodhimin, magazinimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave, duke respektuar ligjin për mbeturinat (Ligji Nr. 08/L-071, për plotësim dhe ndryshim të Ligjit Nr. 04/L-060). Qëllimet kryesore të planit: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Reduktimi i prodhimit të mbeturinave <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Zvogëlimi i mbeturinave të gjeneruara nga aktiviteti i prodhimit të betonit.</li> <li>○ Klasifikimi dhe magazinimi i përkohshëm i mbeturinave në përputhje me rregullat ligjore.</li> </ul> </li> <li>2. Menaxhimi i mbeturinave të ngurta komunale <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Mbeturinat grumbullohen dhe klasifikohen sipas llojit.</li> <li>○ Vendosen në kontejnerë të posaçëm, të pajisur me kapak për mbulim, për të parandaluar ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësorë.</li> </ul> </li> <li>3. Menaxhimi i vajrave të përdorura dhe mbeturinave të rrezikshme <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Vajrat dhe lubrifikantët e përdorur grumbullohen dhe magazinohen në fuqi të mbyllura dhe të siguruara.</li> <li>○ Pas magazinimit të përkohshëm, dorëzohen tek kompanitë e licencuara për grumbullim dhe trajtim.</li> </ul> </li> </ol>

		<p>4. Zbatimi i masave parandaluese dhe mjedisore</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Evitimi dhe reduktimi i prodhimit të mbeturinave.</li> <li>○ Përdorimi i teknikave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut.</li> <li>○ Përcaktimi i mënyrës së magazinimit, trajtimit dhe deponimit të mbeturinave.</li> </ul> <p>Përfitimet e planit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguron një menaxhim të kontrolluar dhe të sigurt të mbeturinave.</li> <li>• Parandalon ndikimin negativ të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut.</li> <li>• Garanton përputhshmëri me ligjin dhe standardet mjedisore.</li> </ul>
8.6.	Raportimi	//

<b>9. RREZIKU NGA AKSIDENTET</b>		
9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	<p><b>Plani i mbrendshem do te permbanë:</b></p> <p><b>Objektivat e Planit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve,</li> <li>➤ Ruajtja dhe mbrojtja e ambientit,</li> <li>➤ Vlerësimi i rrezikut, parandalimi i zjarreve mbrojtja dhe ruajtja e pasurisë dhe të mirave materiale,</li> </ul> <p><b>Qëllimi i planit:</b></p> <p>Qëllimi i hartimit të këtij Plani është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zvogëlimi të rrezikut,</li> <li>• Gadishmeria për të marrë vendime të duhura dhe kordinimi i veprimeve (në raste të zjarreve përmasash të mëdha),</li> <li>• Krijimi i prioriteteve për një kordinim sa më efikas në mes të subjekteve të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe me efikasitet në rastet e fatkeqësive – zjarreve.</li> </ul> <p><b>Plani i jashtëm</b></p> <p>Qëllimet kryesore të këtij Plani janë: Tërheqja e vëmendjes së përdoruesve dhe të autoriteteve përkatëse ndaj mundësisë së ndodhjes së një aksidenti dhe zbatimit të</p>

		<p>masave për shmangien e tij, të shmangë efektet serioze (si p.sh. vdekjet nga aksidentet), të zvogëlojë shfaqjen e efekteve, të zvogelojë rrezikun e ndodhjes së aksidenteve ose të zbusë pasojat e aksidenteve kur ato ndodhin.</p> <p>Për realizimin e objektivave të mësipërme, ky plan përmban këto qështje kryesore: ekipet e emergjencave dhe përgjegjësit e tyre, trajnimi i punëtorëve, klasifikimi i territorit sipas kategorise së kërcënimit nga aksidentet, përgjegjësitë.</p>
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	<p>Kompania – betoniera “<b>Renelual Tahiri</b>” Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonen kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, nuk përdorë substancave të rrezikshme kimike dhe preparate, përveç aditive të cilët për qëllime të lartëcekuar shtohen në beton.</p>
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	<p><b>Masat që janë marrë në raste aksidenti</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Janë marrë masat për evidentimin e derdhjeve të derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese si dhe aditivët që shërbejnë për prodhimin e betonit.</li> <li>- Në rastet kur kemi rrjedhje të vajrave dhe fluideve si mbeturina specifike që mund të ndodhin gjatë procesit, atëherë lëngu i derdhur pastrohet me absorbues kimik të cilat me lopata mbledhen dhe futen në fuqi ku mbahen në depo derisa të merrën nga kompanitë e licencuara për trajtimin e tyre.</li> <li>- Në mënyrë permanente mirëmbahet ambienti në kompleks të bazes së betonit.</li> <li>- E tërë sipërfaqja e bazës së betonit është e rrethuar me mure dhe tel xhëmbor.</li> <li>- Janë marrë të gjitha masat për dhënjën e ndihmës së parë.</li> </ul>
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	<p><b><u>Raporti i sigurisë përmbanë këto të dhëna dhe informata:</u></b> - Shënimet e lokacionit ku gjendet impianti, duke përfshirë pozitën gjeografike, kushtet meteorologjike, gjeologjike dhe hidro-grafike, të dhënat mbi terrenin; përcaktimi i stabilimenteve dhe aktiviteteve të tjera të impiantit të cilat mund të paraqesin rrezik nga aksidentet</p>

		<p>e mëdha; përshkrimi i zonave ku mund të vij deri te efekti domino nga aksidenti i madh, përshkrimi i aktiviteteve kryesore, burimit të rrezikut nga aksidentet e mëdha dhe rrethanave nën të cilat një aksident i tillë mund të ndodhë si dhe përshkrimi i masave preventive të planifikuara; përshkrimi i procedurave, në rend të parë mënyra e punës;</p> <p><b><u>Përshkrimi i substancave të rrezikshme, i cili përfshin:</u></b> - Sasinë më të madhe të substancave të rrezikshme që mund të jenë të pranishme në lokacion; vetitë fizike, kimike dhe toksikologjike të substancave të rrezikshme dhe paralajmërimet e rrezikut për njeriun dhe Mjedisin, vërtetimin e substancave të rrezikshme: emërtimi kimik, numri CAS (Chemical Abstract Simbol), emërtimi sipas nomenklaturës IUPAC.</p> <p>Vërtetimi dhe analiza e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mënyra e pengimit.</p> <p>Vlerësimi i pasojave të konstatuara nga aksidenti i madh. Përshkrimi i pajisjeve të shfrytëzuara gjatë sigurimit të stabilimenteve.</p> <p>Përshkrimi detal i rrjedhjes së mundshme të aksidenteve të mëdha dhe mundësisë së ndodhjes së tyre ose kushtet nën të cilat mund të ndodhin, duke përfshirë përshkrimin e situatës që mund të shkaktojnë në njërin nga zhvillimet e cekura të saj, pa marrë parasysh se a janë shkaktarët brenda stabilimentit ose jashtë tij.</p>
9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	<p>Në rast të aksidenteve mjedisore-zjarri, mbrojtja planifikohet të bëhet evakuimi i detyrueshëm i personave në rrezik nga ndërtesa ku ka ndodhur zjarri kritike për të siguruar objektivin themelor të mbrojtjes së njerëzve dhe ndërtesës nga zjarri. Ndodhja aksidentale e zjarrit shkakton një situatë mjaft stresuese, dhe reagimi i njerëzve është i paparashikueshëm. Për dallim nga çdo ditë duke e lënë objektin në përdorim normal, evakuim të detyruar në rast një zjarr ndodh papritur, pa mundësinë e parashikimit të tij. Elementet paniku, i cili është i pranishëm në situata të tilla, vetëm e vështirëson evakuimin.</p> <p><b>Procedurat e evakuimit në rast zjarri:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të sigurojë evakuimin e sigurt të personave të cenueshëm dhe pajisjeve të vlefshme,</li> </ul>

- Shuarja dhe lokalizimi i zjarrit dhe ruajtja e integritetit dhe stabilitetit të ndërtesës.

Parandalimi i zjarrit në betonierë zbatohet në mënyrë më efektive nga aplikimi materiale jo të djegshme në elemente strukturorë kudo që të jenë të jetë e mundur. Në këtë drejtim, duhet të bëhet zëvendësimi i materialit që është më lehtë i ndezshëm ose ka një fuqi termike më të lartë, me një material që ka një temperaturë më të ulët ndezja dhe prodhimi më pak i nxehtësisë. Një masë aktive gjithashtu përfshin zvogëlimin sasia e përgjithshme e ngarkesës masive të zjarrit në objekt, duke e zvogëluar atë temperatura e procesit termik, përqendrimi i zjarrit, temperatura e flakës dhe shkëndijat etj dhe duhet pasur kujdes edhe për mbajtjen e burimit të nxehtësisë në afërsi të karburantit të temës. Shuarja e flakës së pilotit (e vogël - fillestare) pas humbjes kontrolli i zjarrit është i mundur me mjete të përshtatshme, ndonjëherë edhe me anë të shuarjes një këpucë e zakonshme pranë zjarrit. Për të kontrolluar zjarrin gjatë fillimit faza dhe likuidimi i saj i hershëm është zgjidhja më e mirë duke përdorur pajisjet mobile kunder zjarrit te cilat mund të përdoret nga të gjithë personat.

Nëse zjarri nuk arriti të shuhet me një pajisje "S" ose "CO<sub>2</sub>", në raste te tilla nevojitet me shumë kontroll dhe nevojitet më shumë ndërhyrje - duhet të përfshihen me shume njerez me më shumë pajisje (makineritë fillestare të zjarrit dhe rrjeti i brendshëm hidrant). Pas kësaj mund të fillojë me evakuimi, duke pasur parasysh që një numër personash nuk janë kompetent për ekspertin ndërhyrja, dhe në shumë raste ato pengohen nga paniku i tyre ndërhyrje. Për të siguruar evakuimin efikas është i nevojshëm të sigurojë integritetin e strukturës në komunikimet rrugore dhe ambientin karakteristikat nën faktorin e rrezikut në kohën e evakuimit.

Një zjarr zjarri duhet të japë mundësinë e suksesit edhe kur pika qendrore është e madhe dhe disa dhjetëra m<sup>2</sup>. Në këtë fazë, instalimet e shuarjes së qëndrueshme përdoren me pjesëmarrjen e anëtarëve të një brigade profesionale zjarri.

**Procedura e shuarjes kryhet në fazat vijuese:**

		<p><b>Faza e Parë I</b> - Zjarri përfshin fikjen e energjisë elektrike dhe hyrjen e zjarrfikësve me pajisje të mbajtura me dorë ose ujë nga një rrjet hidrant.</p> <p>Për përdorimin e aparateve të zjarrit të tipit 6 dhe 9 kg të tipit S veprimet duhet të kryhen në rendin e mëposhtëm:</p> <p>Siguroni pajisjen në vend sa më shpejt që të jetë e mundur Zjarri, tërheq levën në valvulën e pajisjes, godet levën e luajtshme në valvulën e pajisjes me pëllëmbën e dorës, prisni 5 sekonda, dhe ktheni grykën drejt zjarrit dhe shtypni gungën plotësisht. Koha e veprimit është 18 sekonda dhe rrezja e është 4 m. Për të përdorur një zjarrfikës 5 CO<sub>2</sub>.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kompania ka siguruar paisjet kunder zjarrit</li> <li>- Janë trajnuar shumica e punëtorëve për përdorimin e pasijeve kunder zjarrit</li> </ul> <p>Janë marrë masa për sigurinë e pergjithshme kundër pëlçitjes aksidentale apo të qëllimshme të zjarrit</p>
--	--	---

<b>10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT</b>		
10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Në rastet se vërehet se kemi funksionim jo stabile të betonierës, bëhet ndërprerja momentale e punës dhe fillon kontrollimin për të gjetur shkakun, përse nuk kemi rrjedhje normale të punës. Pas gjetjes së defektit dhe rikuperimit të tij, bëhet testimi dhe lëshohet në punë i betonierës. Ndërsa në kushtë normale nuk ka ndërprerja momentale e punës së Betonierës përveq nese kemi nderprerje momentale të rrymës elektrike. Gjithnjë sipas pronarit të betonierës.
10.2.	Ndërprerja e punës	Nuk ka ndalje të punës

<b>11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT</b>
<p>Gjatë funksionimit kontinuel të kompleksit të Kompanisë betoniera “Renelual Tahiri”- Sh.p.k, Bazë për prodhimin e betonit në zonen kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, e cila si aktivitet ka prodhimin e betonit, pas ndërmarrjes e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe respektimin e plotë të udhëzimeve të dhëna në raportin e VNM dhe aplikacionit të Lejës Mjedisore, të parapara me udhëzimet administrative dhe ligjet</p>

në fuqi, atëherë ndikimi i mundshëm i ndotjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut konsiderohet të jetë minimal.

**Personi përgjegjës për mjedis**

**Emri mbiemri**

**Dr.sc. Edona Kabashi Kastrati**

**Nënshkrimi**

---

**Personi përgjegjës i kompanisë**

**Emri Mbiemri:**

**z. Refki Hoxha**

**Nënshkrimi**

---